1043. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 8, dosari 13, dosje përpunimi nr. 180, në ngarkim të M.N.K., me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1951–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1044. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 8, dosari 13, dosje përpunimi nr. 1267, në ngarkim të M.K.M., me 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1045. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 8, dosari 13, dosje përpunimi nr. 2962, në ngarkim të L.P.V., me 279 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1963–1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1046. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 8, dosari 13, dosje përpunimi nr. 3070, në ngarkim të V.M.Ç., me 45 (dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1976–1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
1047. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 14, dosje përpunimi nr. 3489, në ngarkim të Rr.M.B., me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1971–1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1048. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 14, dosje përpunimi nr. 3409, në ngarkim të V.M.M., me 30 (tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1049. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 14, dosje përpunimi nr. 427, në ngarkim të N.Z.Gj., me 108 (njëqind e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1952–1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1050. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 14, dosje përpunimi nr. 3254, në ngarkim të M.P.P., me 47 (dyzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1972–1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1051. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 14, dosje përpunimi nr. 590, në ngarkim të H.O.A., me 236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1052. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 14, dosje përpunimi nr. 2818, në ngarkim të Gj.C.M., me 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1974–1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1053. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 14, dosje përpunimi nr. 371, në ngarkim të M.Gj.T., me 219 (dyqind e nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1054. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 14, dosje përpunimi nr. 519, në ngarkim të Gj.P.T., me 279 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1954–1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1055. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 14, dosje përpunimi nr. 634, në ngarkim të Z.N.Gj., me 171 (njëqind e shtatëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1944–1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1056. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 16, dosje përpunimi nr. 3280, në ngarkim të Ll.K.M., me 44 (dyzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1057. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 16, dosje përpunimi nr. 3248, në ngarkim të L.H.H., me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1972–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1058. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 16, dosje përpunimi nr. 134, në ngarkim të Gj.M.M., me 121 (njëqind e njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1954–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1059. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 16, dosje përpunimi nr. 2297, në ngarkim të M.N.F., me 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1955–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1060. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 9, dosari 16, dosje përpunimi nr. 3534, në ngarkim të D.N.L., me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1061. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 10, dosari 15, dosje përpunimi nr. 3189, në ngarkim të J.J.O., me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1977–1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
1062. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 10, dosari 15, dosje përpunimi nr. 6428, në ngarkim të P.P.P., me 673 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1977–1990. Niveli i klas-

ifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1063. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 10, dosari 17, dosje përpunimi nr. 2049, në ngarkim të A.L.N. (J.), me 157 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1957–1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1064. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 10, dosari 17, dosje përpunimi nr. 4541, në ngarkim të N.N.N., me 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1065. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 10, dosari 17, dosje përpunimi nr. 3756, në ngarkim të Z.L.Gj., me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1979–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1066. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 10, dosari 17, dosje përpunimi nr. 424, në ngarkim të N.K.V., me 132 (njëqind e tridhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1948–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1067. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 10, dosari 17, dosje përpunimi nr. 163, në ngarkim të S.M.A., me 214 (dyqind e katërmëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1068. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 10, dosari 17, dosje përpunimi nr. 2291, në ngarkim të Z.P.J., me 84 (tetëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1967–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1069. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 10, dosari 17, dosje përpunimi nr. 4547, në ngarkim të F.P.N., me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1070. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 10, dosari 17, dosje përpunimi nr. 5171, në ngarkim të P.N.N., me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1071. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 10, dosari 17, dosje përpunimi nr. 4113, në ngarkim të A.Xh.K., me 70 (shtatëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1072. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 18, dosje përpunimi nr. 4211, në ngarkim të F.T.T., me 126 (njëqind e njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1979–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1073. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 18, dosje përpunimi nr. 2371, në ngarkim të K.B.S., me 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1948–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1074. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 18, dosje përpunimi nr. 2511, në ngarkim të S.Z.J., me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1946–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1075. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 18, dosje përpunimi nr. 6346 dhe dosje pune, në ngarkim të Gj. Z. J., me 171 (njëqind e shtatëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1076. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 18, dosje përpunimi nr. 2455, në ngarkim të Gj.L.N., me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1961–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1077. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 18, dosje përpunimi nr. 174, në ngarkim të M.K.Sh., me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1951–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1078. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 18, dosje përpunimi nr. 5406, në ngarkim të Gj.N.N., me 24 (njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1961–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1079. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 18, dosje përpunimi nr. 5033, në ngarkim të M.R.D., me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1080. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 19, dosje formulare nr. 5284, në ngarkim të P.F.T., me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1081. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 19, dosje formulare nr. 5353, në ngarkim të B.R.A., me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1082. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 19, dosje formulare nr. 3211, në ngarkim të L.Gj.K., me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1977–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1083. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 19, dosje formulare nr. 1556, në ngarkim të K.G.T., me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1963–1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1084. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 19, dosje formulare nr. 2022, në ngarkim të L.B.S., me 275 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1949–1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1085. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 19, dosje formulare nr. 2702, në ngarkim të A.L.M., me 124 (njëqind e njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1974–1976. Niveli i klasifikimit

të dosjes është “Tepër sekret”.

1086. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 19, dosje përpunimi nr. 1459, në ngarkim të Xh.D.H., me 122 (njëqind e njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1962–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1087. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 11, dosari 19, dosje përpunimi nr. 2773/1, në ngarkim të K.Gj.A., me 155 (njëqind e pesëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
1088. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 4, dosari 34, dosje përpunimi nr. 1375, në ngarkim të N.K.N., me 40 (dyzet) fletë. Dosja daton në vitet 1960–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1089. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 4, dosari 34, dosje përpunimi nr. 2349, në ngarkim të Gj.K.Z., me 141 (njëqind e dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1952–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1090. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 4, dosari 34, dosje përpunimi nr. 1512, në ngarkim të A.L.P., me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1963–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1091. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 4, dosari 34, dosje përpunimi nr. 4657, në ngarkim të M.M.T., me 183 (njëqind e tetëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1983–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1092. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 4, dosari 34, dosje përpunimi nr. 5186, në ngarkim të Gj. Z. M., me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1983–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1093. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 4, dosari 34, dosje përpunimi nr. 3541, në ngarkim të Z.J.N., me 28 (njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1094. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 4, dosari 34, dosje përpunimi nr. 1255, në ngarkim të K.L.N., me 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1951–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1095. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 12, dosari 20, dosje formulare nr. 3992, në ngarkim të Xh.I.H., me 25 (njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1096. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 12, dosari 20, dosje formulare nr. 350, në ngarkim të R.A.Ç., me 548 (pesëqind e dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1956–1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1097. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 12, dosari 20, dosje formulare nr. 1522, në ngarkim të N.M.Gj., me 110 (njëqind e dhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1963–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1098. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 12, dosari 20, dosje formulare nr. 884, në ngarkim të N.P.N., me 239 (dyqind e tridhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1959–1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1099. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 12, dosari 20, dosje përpunimi nr. 3668, në ngarkim të H.Sh.M., me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1979–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1100. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 12, dosari 21, dosje përpunimi nr. 3256, në ngarkim të L.Gj.P. (S.), me 301 (treqind e një) fletë. Dosja daton në vitet 1971–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1101. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 12, dosari 21, dosje përpunimi nr. 5876, në ngarkim të R.HP., me 294 (dyqind e nëntëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1973–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1102. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 12, dosari 21, dosje formulare nr. 3712, në ngarkim të N.D.S., me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1979–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1103. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 12, dosari 21, dosje formulare nr. 1553, në ngarkim të M.T.K., me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1964–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1104. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 22, dosje formulare nr. 5402, në ngarkim të M.H.N., me 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1105. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 22, dosje përpunimi nr. 813, në ngarkim të LC. D., me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1952–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1106. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 22, dosje formulare nr. 3519, në ngarkim të L.P.B., me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1975–1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1107. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 22, dosje formulare nr. 6448, në ngarkim të A.Gj.F., me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1108. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 22, dosje përpunimi nr. 2575, në ngarkim të I.C.B., me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1967–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

është “Tepër sekret”.

1109. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 22, dosje përpunimi nr. 177, në ngarkim të L.Gj.B., me 42 (dyzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1948–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1110. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 22, dosje përpunimi nr. 2500, në ngarkim të M.K.P., me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitet 1973–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1111. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 22, dosje formulare nr. 2521, në ngarkim të E.B.L., me 167 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1112. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 22, dosje përpunimi nr. 1183, në ngarkim të Gj.P.G. (Gj.), me 48 (dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1961–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1113. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 22, dosje përpunimi nr. 5630, në ngarkim të V.JT., me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1114. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje përpunimi nr. 816, në ngarkim të C.A.T., me 121 (njëqind e njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1115. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje përpunimi nr. 4650, në ngarkim të A.M.K., me 129 (njëqind e njëzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1962–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1116. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje përpunimi nr. 1852, në ngarkim të L.N.K., me 120 (njëqind e njëzet) fletë. Dosja daton në vitet 1950–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1117. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje përpunimi nr. 1801, në ngarkim të M.P.M., me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1960–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1118. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje përpunimi nr. 6381, në ngarkim të Gj.M.B., me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1119. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje përpunimi nr. 3530, në ngarkim të K.L.R., me 80 (tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1950–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1120. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje formulare nr. 3933, në ngarkim të L.N.K., me 21 (njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1976–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1121. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje formulare nr. 3612, në ngarkim të P.K.P., me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1979–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1122. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje formulare nr. 5071, në ngarkim të A.K.R., me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1956–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1123. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje formulare nr. 396, në ngarkim të L.M.Gj., me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1124. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje përpunimi nr. 6562, në ngarkim të S.F.C., me 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
1125. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje përpunimi nr. 5204, në ngarkim të M.P.N., me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1126. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 13, dosari 23, dosje përpunimi nr. 4600 si dhe fashikull personal për të dënuar, në ngarkim të M.P.P., me 40 (dyzet) fletë. Dosja daton në vitet 1974–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1127. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 14, dosari 24, dosje përpunimi nr. 4010, në ngarkim të Th.A.D., me 330 (treqind e tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1960–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1128. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 14, dosari 24, dosje përpunimi nr. 5106 dhe fashikull personal për të dënuar, në ngarkim të B. B. Ç., me 199 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1129. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 14, dosari 25, dosje përpunimi nr. 4796, në ngarkim të N.Gj.T., me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1976–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1130. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 14, dosari 25, dosje përpunimi nr. 1602, në ngarkim të D.B.Sh. (P.), me 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1950–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1131. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 14, dosari 25, dosje përpunimi nr. 3202, në ngarkim të L.L.L., me 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1945–1991. Niveli i klasifikimit

të dosjes është “Tepër sekret”.

1132. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 15, dosari 26, dosje përpunimi nr. 2352, në ngarkim të A.Z.V. (M.), me 221 (dyqind e njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1963–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1133. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 15, dosari 26, dosje përpunimi nr. 1945, në ngarkim të E.F.A., me 50 (pesëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1972–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1134. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 15, dosari 26, dosje përpunimi nr. 3151, në ngarkim të Z.P.R., me 84 (tetëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1976–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1135. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 15, dosari 26, dosje përpunimi nr. 352, në ngarkim të H.O.K., me 28 (njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1947–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1136. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 15, dosari 26, dosje përpunimi nr. 2793, në ngarkim të R.M.Sh., me 122 (njëqind e njëzet dy) fletë. Dosja daton në vitet 1955–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1137. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 15, dosari 26, dosje përpunimi nr. 622, në ngarkim të L.K.S., me 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1955–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1138. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 15, dosari 27, dosje përpunimi nr. 724, në ngarkim të P.Gj.M., me 105 (njëqind e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1946–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1139. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 15, dosari 27, dosje përpunimi nr. 2761, në ngarkim të Nj.L.S., me 269 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1955–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
1140. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, kutia 15, dosari 27, dosje përpunimi nr. 5471, në ngarkim të N.H.J., me 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

KRYETARI I KDZH

Dr. Gentiana Sula




KUJTESA DHE EDUKIMI QYTETAR

DOKUMENTET ORIGINALE PËR HERË TË PARË PËR PUBLIKUN - EKSPOZOHET DOSJA E PËRNDJEKJES SË MAKS VELOS NGA ISH-SIGURIMI I SHTETIT

Tiranë, 6 maj 2025

Në kuadër të 5-vjetorit të ndarjes nga jeta të arkitektit, artistit dhe intelektualit Maks Velo, në ambientet e “Shtëpive-Studio Kadare–Agolli” u çel ekspozita përkujtimore dedikuar jetës dhe veprës së tij. Pjesë e kësaj ekspozite janë për herë të parë dokumente arkivore origjinale nga dosja e përndjekjes së tij nga Sigurimi i Shtetit, të vëna në dispozicion nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH).



Anëtari drejtues i Autoritetit, z. Altin Hoxha, gjatë hapjes së aktivitetit theksoi rëndësinë e këtyre dokumenteve si dëshmi të qarta të represionit ndaj artistëve dhe mendimit të lirë në diktaturë. “Dokumentet e përfshira – një dosje formulare dhe një dosje hetimore-gjyqësore – zbulojnë mekanizmat e ndëshkimit për mendimin ndryshe. Ato përmbajnë raporte agjenturore, survejim të pandërprerë, presion për bashkëpunim me Sigurimin, dhe më pas ndëshkimin me burg”, deklaroi z. Hoxha.

Maks Velo u dënua në vitin 1978 me 10 vjet burg për agjitacion e propagandë, dhe u lirua në vitin 1986. Ai u bë ndër të parët që publikoi dokumentet e ndëshkimit të tij sapo Autoriteti u ngrit në vitin 2017, duke i kthyer ato në dëshmi publike me vlerë edukative dhe historike.

AIDSSH-ja e shihet këtë bashkëpunim me “Shtëpi-Studio Kadare–Agolli” si një hap në funksion të transparencës, edukimit qytetar dhe ndërgjegjësisë shoqërore mbi të kaluarën, në mënyrë që të mos përsëriten mekanizmat e tillë shtypës.

AKADEMIKJA AMERIKANE VIZITON AIDSSH-NË - SHQIPËRIA NË ENCIKLOPEDI NË NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË TRANZITORE

Tiranë, 7 maj 2025

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) mirëpriti vizitën e profesoreshës amerikane Cynthia Horne, eksperte e njohur në fushën e drejtësisë tranzitore dhe pedagoge në Universitetin Perëndimor të Uashingtonit (Western Washington University), SHBA.

Profesoresha Horne u prit nga anëtarët e Autoritetit, z. Altin Hoxha dhe anëtari z. Albert Nikolla, si dhe nga stafi profesional i institucionit.





Gjatë takimit, ajo mori përgjigje të detajuara për të gjitha pyetjet e saj në lidhje me funksionimin e AIDSSH-së, proceset e digjitalizimit, administrimin e fondeve arkivore dhe misionin gjithnjë e më të gjerë të ndërgjegjësimit shoqëror dhe ndërkombëtar të institucionit.

“Jam thellësisht e impresionuar nga mikpritja dhe profesionalizmi i stafit të Autoritetit”, deklaroi Horne. “Gjeta një institucion që jo vetëm menaxhon me kujdes dokumentet e së kaluarës, por kontribuon në mënyrë të qenësishme në ndërtimin e kujtesës kolektive dhe forcimin e transparencës publike.”

Gjatë vizitës, ajo pa nga afër fondet arkivore dhe standardet e përparura të menaxhimit dhe organizimit të tyre. Profesoresha Horne theksoi rëndësinë që ka puna e AIDSSH-së në kontekstin e drejtësisë tranzitore dhe edukimit qytetar.

Në përfundim të vizitës, ajo shprehu synimin për të përfshirë përvojën shqiptare në Enciklopedinë Ndërkombëtare të Drejtësisë Tranzitore, me qëllim që akademikët dhe studiuesit nga vende të ndryshme të kenë akses në informacionin dhe përvojën unike që ofron Shqipëria në këtë fushë.

VIZITË STUDIMORE - AIDSSH NË INSTITUTIN E KUJTESËS KOMBËTARE, VARSHAVË

Varshavë, 13 maj 2025



Përfaqësues të Autoritetit Shqiptar për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) zhvilluan një vizitë studimore në selinë e Institutit të Kujtesës Kombëtare në Varshavë.

Qëllimi kryesor i vizitorëve ishte të përfitonin nga përvoja e gjerë e këtij institucioni në hetimin e regjimit komunist të përmbysur tridhjetë e pesë vjet më parë, duke përfshirë veprimet ligjore dhe kërkimin e mbetjeve të viktimave. Delegacioni ishte veçanërisht i interesuar të mësonte rreth mënyrave se si mblidhen dhe përdoren dëshmitë e dëshmitarëve, sepse AIDSSH po planifikon të zbatojë njohuritë e IPN-së në dokumentimin e rrëfimeve dhe kërkimin e viktimave, gjetjen e varreve dhe krijimin e vendeve të përkujtimit.

52-VJETORI I REVOLTËS SË SPAÇIT - AIDSSH-JA PREZANTON ARKIVIN DIGJITAL WWW.SPAC.AL

Tiranë, 20 maj 2025

Me rastin e 52-vjetorit të Revoltës së Spaçit, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit organizoi një ceremoni përkujtimore në ambientet e Bibliotekës së Kryeministrit (COD) duke prezantuar për herë të parë platformën digjitale www.spac.al, një arkiv i hapur për dokumentimin dhe edukimin mbi historinë e kamp-burgut të Spaçit dhe krimet e komunizmit në Shqipëri.





Në fjalën e saj, kryetarja e AIDSSH, znj. Gentiana Sula, theksoi rëndësinë e dokumentimit të së shkuarës për të ndërtuar një të ardhme më të drejtë: “Revolta e Spaçit dhe historitë e mbi 2 000 të dënuarve politikë janë një testament i fuqisë së shpirtit njerëzor për të mos u dorëzuar. Ne nuk mund të ndryshojmë atë që ndodhi, por mund të ndryshojmë fundin e saj përmes dokumentimit, edukimit dhe rivendosjes së dinjitetit për ata që vuajtën padrejtësisht.”

Znj. Sula nënvizoi gjithashtu përpjekjet institucionale për të adresuar padrejtësitë dhe stigmat që ndjekin të përndjekurit politikë:

“Autoriteti ka propozuar ndryshime ligjore për njohjen zyrtare të vuajtjeve të tyre, përfshirë periudhat e internimit, punën e papaguar, të drejtat e pensionit për të burgosurit e minierave dhe muzealizimin e Spaçit. Këto janë hapa të domosdoshëm për të çrrënjësuar diskriminimin dhe për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe më humane.”

Ambasadori i Gjermanisë në Shqipëri, z. Karl Bergner, vlerësoi rolin e kujtesës në forcimin e demokracisë, si dhe përgëzoi AIDSSH-n për krijimin e këtij arkivi digjital që jo vetëm ruan kujtesën për të shkuarën, por edhe përcjell mësim për brezin e ri. “Ju paguat çmimin e lirisë. Kujtesa është themeli i një shoqërie të shëndetshme dhe e nevojshme për të ndërtuar të ardhmen me përgjegjësi.”

Z. Gjergj Marku, anëtar i Autoritetit dhe kryetar i grupit të punës për dokumentimin e Spaçit, theksoi: “Ne kërkojmë që Spaçi të kthehet në një vend të kujtesës kombëtare, në një muze kombëtar dhe një qendër edukimi për brezat e rinj. Ky vend nuk është thjesht një ish-burg; është një simbol i dhimbjes, por edhe i qëndresës njerëzore. Spaçi është plagë, por edhe krenari. Është errësirë, por edhe dritë. Është dëshmi, por edhe amanet. Qëndrojmë të angazhuar që heshtja dhe harresa të mos mbulojnë një histori që i përket çdo shqiptari që beson në liri. Kemi për detyrë të mos lejojmë që viktimat të harrohen dhe krimet të fshihen nga kujtesa kolektive.”

Platforma sjell për publikun lista të të dënuarve, dëshmi gojore, intervista, letërkëmbime dhe dokumente zyrtare, përfshirë materialet mbi revoltën e Majit 1973, si një mjet për reflektim qytetar dhe edukim ndërbrezor.

Ish-i dënuari politik Lekë Mirakaj e cilësoi revoltën e Spaçit si një moment kulmor të dinjitetit kombëtar: “Revolta e Spaçit është ndër kulmet e krenarisë kombëtare. Shteti duhet të kujdeset dhe të garantojë pension dinjitoz për të burgosurit politikë, jo më pak se sa ata që kanë shërbyer në organet shtypëse.”

Nestor Topençarov, një tjetër i mbijetuar i kampit të Spaçit, ndau me publikun përvojën e tij të burgut: “Çdo ditë ishte stres. I mbyllur mes maleve, rrethuar me tela me gjemba. Kur hyje në galeri, nuk e dije a do të dilje. Kur ktheheshe në kamp, policët të provokonin për të të futur në birucë.”

“Në këtë ditë kujtese, nuk mund të mos rikujtojmë ekzekutimin



e katër të rinjve të guximshëm të mbetur pa varr, Pal Zefit, Dervish Bejkos, Skënder Dajës, Hajri Pashajt.” - tha Nuri Stepa, një tjetër pjesëmarrës në Revoltë.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit rithekson angazhimin për të ruajtur kujtesën historike dhe për të siguruar që vuajtjet e ish-të përndjekurve të mos fshihen, por të shërbejnë si burim edukimi për brezat e ardhshëm.



AIDSSH DHE AKADEMIA E SHKENCAVE - MBAHET SIMPOZIUMI “LËVIZJA E 1968-S PËR REVOLUCIONARIZIMIN E JETËS NË SHQIPËRI”

Tiranë, 29 maj 2025

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) shënoi dje bashkëpunimin e radhës me Akademinë e Shkencave, seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, në zhvillimin e simpoziumit me temë “Lëvizja e 1968-ës për revolucionarizimin e jetës në Shqipëri”.

Qëllimi i simpoziumit ishte të sillte në vëmendje dinamikat historike dhe studimet mbi ndikimin e vitit 1968 në Shqipëri, si dhe të hidhte dritë mbi mënyrën e përvetësimit dhe aplikimit të modelit të Revolucionit Kulturor Kinez në kontekstin shqiptar – me një qasje analitike dhe antropologjike të thelluar.

Akademiku Albert Doja, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të përhershëm të antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore, theksoi se kjo ishte veprimtaria e parë e këtij komisioni të sapoformuar, duke falënderuar studiuesin dhe autorin Albert P. Nikolla për nismën dhe për librin e tij “Antikultura e ‘68-s në Shqipëri”, që shërbeu si pikënisje për këtë simpozium. Ai nënvizoi se përqendrimi në vitin 1968 është një mënyrë për të analizuar transformimet ideologjike përmes një lente antropologjike të pasur dhe reflektuese.



Prof. asoc. Albert P. Nikolla, i cili aktualisht mban detyrën e anëtarit të Autoritetit, në kumtesën e tij, trajtoi ndikimin e Revolucionit Kulturor Kinez në Shqipëri dhe tragjedinë e imitimit të tij, përmes një studimi konkret në fshatin Hajmel të Shkodrës, duke analizuar shkatërrimin e Kishës Katolike dhe persekutimin e priftërinjve. Ai solli dokumente që dëshmojnë fushatat e organizuara nga shteti dhe vetë populli, duke u mbështetur në veprat e Enver Hoxhës si “udhëzues të sjelljes” për realizimin e këtij “revolucion nga poshtë”. Nikolla argumentoi se viti 1967, dhe jo thjesht 1968-a globale, ishte pika kulmore e dhunës ndaj fesë dhe trashëgimisë shpirtërore në Shqipëri.

Akademik Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, i cili vlerësoi tematikën për aktualitetin dhe rëndësinë në kuadrin e studimeve të thelluara për antropologjinë e tranzicionit shqiptar.

Prof. Dr. Enika Abazit, Departamenti i Shkencave Politike të Universitetit të Tiranës, në kumtesën me titull: “Revolucioni i 1968-s në Shqipëri: Revolucionarizimi i mendimit dhe identitetit: Ideali i ‘Njeriut të Ri’ dhe procesi i transformimit ideologjik”. Ajo argumentoi se regjimi komunist ndërtoi një superstrukturë kulturore totalitare, e cila promovoi modelin e “njeriut të ri” në përputhje me ideologjinë marksiste-leniniste. Ajo theksoi se ndërhyrja në kulturën dhe identitetin e individit mbetet një trashëgimi e pashkëputur, që ndikon ende në mënyrën si individët reagojnë sot ndaj lirisë dhe përgjegjësisë.

Prof. asoc. Klodiana Beshku dhe prof. as. Klejd Këllici paraqitën kumtesën me titull: “Viti 1968: Vala e dytë e feminizmit në Perëndim dhe ‘emancipimi si sakrificë’ në Shqipëri”. Analiza e tyre krahasuese solli në vëmendje ndryshimet konceptuale midis diskursit emancipues perëndimor dhe atij të ndërtuar nga partia-shtet në Shqipëri. Ata theksuan se,



ndryshe nga Perëndimi ku lëvizja feministe ishte një akt rezistence ndaj sistemit patriarkal, në Shqipëri emancipimi i gruas ishte i kontrolluar dhe i kanalizuar politikisht – një “sakrificë” brenda strukturave ekzistuese.

Prof. asoc. Majlinda Keta, nga ana e saj, solli një qasje filozofike mbi profilin e “njeriut të ri socialist” dhe përballjen e tij me realitetin e pas viteve ‘90. Ajo theksoi se modeli i një njeriu të formësuar sipas dogmës shtetërore është shndërruar në një pasuri për studimet filozofike mbi tranzicionin postkomunist, ku figura e individit mbetet e fragmentuar dhe shpesh në konflikt me vlerat e demokracisë moderne.

Mrs. Elona Baçi, specialiste e AIDSSH, paraqiti dokumente të përzgjedhura nga fondet arkivore që lidhen me Festivalin e 11-të të Këngës në RTSH, veçanërisht rastin e këngëtarit Sherif Merdani, i cili u burgos për “frymën e huaj” që përfaqësonte stili i tij muzikor. Ajo solli gjithashtu dokumente mbi lëvizjen e Spaçit, duke lidhur ngjarjet kulturore me reagimin politik dhe represiv të regjimit ndaj çdo lloji shprehjeje që sfidonte normën ideologjike.

Në përmbyllje, u bë një apel për të integruar këtë trashëgimi komplekse në narrativën e re arsimore dhe publike, për të ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie që njeh rrënjët e së kaluarës dhe ndërton mbi to reflektimin kritik, kulturën e lirisë dhe respektin për diversitetin.

VIZITË E REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS - DREJT NJË BASHKËPUNIMI TË THELLUAR PËR STUDIMIN E SË KALUARËS KOMUNISTE

Tiranë, 3 qershor 2025

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit priti në një vizitë zyrtare Rektorin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Prof. Dr. Tonin Gjuraraj. Takimi me Kryetaren e AIDSSH-s, znj. Gentiana Sula, synoi nxitjen e një bashkëpunimi konkret për përfshirjen e universiteteve publike në procesin e dokumentimit dhe ndriçimit të së kaluarës komuniste, përmes përdorimit shkencor të arkivave të ish-Sigurimit të Shtetit.

Prof. Dr. Gjuraraj vlerësoi rolin e Autoritetit si një urë e rëndësishme ndërmjet brezit të ri dhe kujtesës historike: “Historia shpesh është një keqkuptim i gjatë dhe ka nevojë për një rishikim të ndershëm. Dosjet, fotografitë dhe dokumentet e ruajtura në këtë institucion janë të një vlere të veçantë për studimet akademike, të cilat duhet të jenë të shoqëruara nga burime dhe dëshmi konkrete. Universitetet tona mund dhe duhet të angazhohen për të hulumtuar jetët e individëve dhe ngjarjet tragjike që nuk kanë marrë ende dritën që meritojnë.”



“Autoriteti mirëpret çdo nismë nga institucionet arsimore për të sjellë të vërtetën më afër brezave të rinj. Këto dokumente nuk janë vetëm histori – janë dëshmi që ndihmojnë në forcimin e demokracisë dhe në përpunimin e së shkuarës.” – shpreh Znj. Sula duke nënvizuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi.

Në takim u diskutua gjithashtu organizimi i një simpoziumi të përbashkët shkencor, që do të zhvillohet në bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës dhe Bashkinë e Shkodrës. Ky simpozium do të trajtojë ngjarjet në kufi dhe metodat e ndjekura nga Sigurimi i Shtetit për kontrollin dhe shtypjen e popullsisë në këtë qark gjatë periudhës së diktaturës. Simpoziumi do të shërbejë si platformë për të ekspozuar fakte, emra dhe dëshmi që lidhen me personat e vrarë apo zhdukur në përpjekje për të kaluar kufirin, si dhe për të trajtuar aspektin memorial dhe përgjegjësinë ndaj brezave të rinj.

Znj. Nertila Seitaj, Drejtore e Drejtorisë së Procesit të Verifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur, solli në vëmendje se simpoziumi që do të mbahet së shpejti në Shkodër, në bashkëpunim me Universitetin dhe Bashkinë ka nxitur interesin e studiuesve dhe synon me tej ngritjen e një memoriali kujtese në këtë qytet.

Në takim, u theksua rëndësia e hapjes së praktikave kërkimore dhe mësimore në ambientet e AIDSSH-s për studentët e universiteteve, për të përgatitur tema diplome apo projekte të thelluara mbi historinë e komunizmit dhe pasojat e tij në jetën e njerëzve.

PLATFORMA DIGJITALE WWW.SPAC.AL NË FOKUS TË MEDIAS - TIRANË TOP CHANNEL “EX-CLUSIVE”, 15 QERSHOR

Në qendër të dokumentarit të emisionit “Exclusive” transmetuar në televizionin kombëtar Top Channel, qëndron puna e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, përmes përpjekjeve për mbledhjen e dokumenteve, dëshmime dhe materialeve arkivore që hedhin dritë mbi historinë e këtij kampi famëkeq.

Gazetarja Sara Hila, autore e Ekskluzives, intervistoi z. Gjergj Marku, anëtar i Autoritetit dhe drejtues i grupit të punës për Spaçin, i cili ka koordinuar mbledhjen e dokumenteve dhe të dëshmimeve si dhe ndërtimin me to, të platformës digjitale www.spac.al dedikuar këtij vendi kujtese.



Platforma tashmë shërben si një burim i besueshëm jo vetëm për median dhe publikun, por gjithashtu për mësuesit e historisë në shkolla, duke përçuar përmes fakteve dhe dokumenteve të hapura realitetin e sistemit represiv.

Dokumentari ka shfrytëzuar në thellësi materialet e këtij portali, duke përfshirë dokumente, fotografi të ish-të dënuarve dhe dëshmi tronditëse.

Në dokumentar marrin pjesë edhe të mbijetuar të njohur si Fatos Lubonja, Nuri Stepa, Demir Pojani, profilet e të cilëve janë pjesë e katalogut të faqes web ndërsa dëshmitë e tyre janë pjesë e arkivit të dëshmimeve gojore të AIDSSH.

AIDSSH NË SIMPOZIUMIN EVROPIAN TË KUJTESËS HISTORIKE - “SHPIRTI I HELSINKIT – 50 VJET PAS”

Helsinki, 10-13.06.2025

Anëtarët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, z. Skënder Vrioni dhe z. Altin Hoxha, si dhe juristi z. Aurel Bekteshi morën pjesë në Konferencën e 13-të Ndërkombëtare të Rrjetit Evropian të Kujtesës dhe Solidaritetit (13th European Remembrance Symposium), e mbajtur në Helsinki, me temën: “Shpirti i Helsinkit -50 vjet pas.”, me rastin e 50-vjetorit të nënshkrimit të Aktit Final të Helsinkit më 1 gusht 1975.

Në këtë simpozium evropian të përvitshëm u nderua arritja diplomatike e Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE), që solli për herë të parë në një tryezë 35 vende përfaqësuese të Perëndimit dhe Lindjes, përfshirë SHBA-në, Kanadanë, Bashkimin Sovjetik dhe shtetet e Evropës Lindore dhe Perëndimore. Ky akt hodhi themelet për procesin e çtensionimit në Evropë dhe ndikoi në mënyrë thelbësore në zhvillimin e lëvizjeve shoqërore dhe disidente në vendet e bllokut lindor, duke çuar në një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën se si kuptohej siguria dhe roli i aktorëve jo-shtetërorë në shoqëri.

Si mund të ndikojë Akti i Helsinkit në proceset e sotme të paqes, çfarë kuptimi kishte siguria në vitin 1975 dhe çfarë kuptimi ka sot, si ndikoi kjo marrëveshje në perceptimet për të drejtat e njeriut dhe në formësimin e hapësirës civile në Lindje dhe në Perëndim janë disa nga çështjet e trajtuara



Nga diskutimet mbi Aktin Final të Helsinkit, u nënvizua se kujtesa dhe e drejta për të ditur të vërtetën nuk janë vetëm përballje me të kaluarën, por edhe themel për një të ardhme më të sigurt dhe paqësore. Shqipëria mëson se transparanca për krimet e së shkuarës forcon besimin në institucionet demokratike.

Shpirti i Helsinkit – si një marrëveshje që lejoi ndërtimin e shpresës për liri brenda vendeve diktatoriale – tregon se edhe nën regjime shtypëse, fjala, dëshmia dhe solidariteti ndërkombëtar janë mjete për ndryshim. Shqipëria mund të rishikojë historinë e vet për të parë se si disidenca shqiptare, megjithëse e shtypur, lidhet me lëvizje më të gjera në Europë.

Konferenca ofroi shembuj të bashkëpunimeve ndërinstitutionale për dokumentimin, edukimin dhe përfshirjen e brezave të rinj në të mësuarit për diktaturën dhe luftën për të drejtat. Shqipëria mëson se ndarja e eksperiencave dhe metodologjive sjell risi në fushën e kujtesës dhe drejtësisë tranzitore.

Debatet në simpozium theksuan rolin e edukimit dhe të rinjve si garantues të lirisë në kohëra sfiduese. Shqipëria përfiton nga ide të reja mbi mënyrat se si mund të përfshijë studentët dhe shoqërinë civile në ruajtjen dhe diskutimin e kujtesës historike.

Përvoja e vendeve të tjera tregon se “shpirti i Helsinkit” i dha fuqi grupeve të pavarura, OJQ-ve dhe individëve për të kërkuar të drejta. Ky është një mesazh aktual edhe për Shqipërinë: një shoqëri demokratike ruhet duke mbrojtur lirinë e fjalës, të organizimit dhe të qasjes në të vërtetën.

Konferenca u organizua nga Rrjeti Evropian i Kujtesës Luftën e Ftohtë (ReCoNet) si dhe Fondacionin Aue. Pjesëmarrësit patën gjithashtu mundësi të vizitonin vende kujtese dhe muze në Helsinki, të lidhura me historinë e qytetit si një skenë e zhvillimeve globale dhe politike në shekullin XX, duke eksploruar arkitekturën dhe artin që pasqyrojnë pozicionin gjeopolitik të Finlandës midis Lindjes dhe Perëndimit.

Një nga objektivat kryesore të këtij simpoziumi ishte forcimi i rrjeteve bashkëpunuese mes institucioneve që merren me historinë e shekullit të 20-të, përfshirë institucione shtetërore, organizata ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, si dhe studiues, edukatorë dhe profesionistë të trashëgimisë kulturore.

KUJTESA KOLEKTIVE DHE STUDIMI I VEPRIMTARISË SË ISH-SIGURIMIT TË SHETIT - AIDSSH DHE UNIVERSITETI I SHKODRËS NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Shkodër, 26.06.2025

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, me synimin kryesor thellimin e kujtesës kolektive dhe studimin e veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, veçanërisht në ndikimin që kjo veprimtari ka pasur në jetën e individëve dhe figurave publike të kohës.



Rektori i Universitetit të Shkodrës, Prof. Tonin Gjuraj, theksoi se marrëveshja mbështetet mbi disa shtylla kryesore: nxitja e kërkimit shkencor, edukimi qytetar, zbardhja e së kaluarës komuniste dhe aksesit në burime arkivore.

“Ka shumë për të eksploruar, por nuk janë bërë ende studime të mjaftueshme. Kjo është një fushë shumë interesante për kërkuesit e rinj,” – theksoi Prof. Gjuraj, duke shtuar se planifikohen edhe vizita studimore pranë AIDSSH.

Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, vlerësoi marrëveshjen si një hap përpara në institucionalizimin akademik të kujtesës historike. “Nuk mjafton që dokumentet të jenë të aksesueshme apo të deklasifikuara; nëse nuk lexohen nga mendjet e duhura, nuk marrin vlerën që meritojnë. Kjo marrëveshje i jep kujtesës një dimension të besueshëm akademik, që synon të heqë stereotipet, të ndalë përçarjet dhe të ndërtojë një të ardhme më të mirë”, - tha znj. Sula e cila nënvizoi rëndësinë e historive lokale, që i japin kujtesës një fytyrë njerëzore: “Secili nga ne ka një histori, një emër, një fytyrë të lidhur me të shkuarën. Në Shkodër, kjo është veçanërisht e fortë, qyteti ka pasur qendresë dhe qytetarë aktivë. Jemi të gatshëm të mbështesim jo vetëm agjendën akademike të Universitetit, por edhe misionin tonë për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut.”



Të pranishëm në takim, anëtarët e AIDSSH-s theksuan rëndësinë që ka hapja e dokumenteve të mbuluara nga “pluhuri i harresës” për rigjallërimin e kujtesës historike.

“Kur të shihen ato dosje, aty është rëndësia. Mjeshtëria e atyre që dinë t’i lexojnë do të mbetet në kujtesën e të rinjve dhe do të rifreskojë historinë”, – u shpreh z. Gjergj Marku.

Z. Altin Hoxha vlerësoi se: “Ky bashkëpunim i shërben zbardhjes profesionale dhe akademike të të shkuarës. Botimi i gjetjeve është shërbimi më i mirë që mund t’i bëjmë publikut. Kjo është rruga për të mos e përsëritur historinë.”

Marrëveshja e bashkëpunimit synon të krijojë ura të reja mes institucionit të kujtesës dhe atij akademik, për të ndihmuar në dokumentimin, kuptimin dhe ndarjen e së kaluarës me shoqërinë. Ajo do të shërbejë për nxitjen e kërkimit

shkencor, për edukimin qytetar të brezave të rinj dhe për promovimin e një qasjeje të ekuilibruar e profesionale ndaj historisë së komunizmit në Shqipëri.



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETËTIT

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga "Kongresi i Manastirit", Garnizoni "Skënderbej", Tiranë